

V E N D I M
Nr. 178, datë 6.3.1998

**PËR CAKTIMIN E EKSPERTËVE FINANCIARË TË PAVARUR NË KONTROLLIN E
REGJISTRAVE OSE LIBRAVE TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE**

Me propozimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në mbështetje të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", kontrollit financiar do t'i nënshtrohen subjektet e kontrollit, si "Vefa Holding" sh.p.k. "Silva" sh.p.k. "Kamberi" sh.p.k. "Cenaj" sh.p.k. "M.Leka" sh.p.k. të cilat ndodhen në administrim.

2. Si ekspertë financiarë të pavarur në subjektet e kontrollit, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, caktohen personat sipas listës nr.1 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

3. Ekspertët financiarë të pavarur janë me cilësinë e ekspertëve të përkohshëm. Ata e ndërpresin ushtrimin e kompetencave të tyre me vendim të Këshillit të Ministrave.

Nëse ekspertët financiarë largohen nga kjo detyrë, ose kur vendi i tyre mbetet i lirë, në përputhje me ligjin, caktohen ekspertë financiarë nga grupi i mbikëqyrjes, sipas listës nr. 2 që i bashkëngjiten këtij vendimi.

4. Ekspertët financiarë të pavarur kërkojnë nga subjektet e kontrollit dhe administratorët gjithë dokumentacionin e nevojshëm financiar për realizimin e funksioneve të tyre, si regjistrat ose librat e shoqërive, bilancet kontabël, kontratat me kreditorët dhe dokumentet e tjera të shoqërisë, nga periudha e fillimit të veprimtarisë së tyre gjer më sot.

5. Për realizimin e funksioneve të tyre, ekspertët financiarë grumbullojnë nga punonjësit e shoqërive huamarrëse dokumentet dhe informacionet e nevojshme për përmbushjen e detyrës së tyre, si dhe marrin në ruajtje kopjet përkatëse të të gjitha dokumentacioneve financiare.

6. Ekspertët financiarë të pavarur, gjatë kohës që ushtrojnë detyrat e tyre pranë shoqërive huamarrëse, i raportojnë here pas here grupit të mbikëqyrjes për përfundimet e kontrollit dhe zbatimin e dispozitave të ligjit për kontabilitetin, si dhe të standarteve ndërkombëtare në këtë fushë.

7. Punonjësit e shoqërive huamarrëse dhe ata që rezultojnë se kanë dokumente financiare të këtyre shoqërive, pavarësisht se mund t'i kenë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këto shoqëri, kur nuk dorëzojnë dokumentacionin financiar dhe pengojnë ekspertët financiarë në përmbushjen e detyrave të tyre, mbajnë përgjegjësi sipas nenit 235 të Kodit Penal.

8. Pagat mujore të ekspertëve financiarë të pavarur janë 35-45 mijë lekë në muaj dhe caktohen nga Grupi i mbikëqyrjes, i cili mban parasysh shtrirjen dhe përmasat e veprimtarisë së shoqërive huamarrëse, numrin e kreditorëve në këto shoqëri etj.

9. Për përballimin e pagave të ekspertëve financiarë të subjekteve të kontrollit, aparatit të Këshillit të Ministrave i shtohen 3.5 milionë lekë në buxhetin e miratuar për vitin 1998.

Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano